

VENDIM
Nr. 3 , datë 4.2.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 40, DATË 16.10.2015, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE “PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR PROGRAMIN
SHQIPËRIA DIXHITALE, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhëj vendimit nr. 40, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për programin Shqipëria dixhitale, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”, bëhen ndryshime, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet sekretariati teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për t’u komunikuar vendimin Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Ministrisë së Financave.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Ndryshim në vendimin nr. 40, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr. 4, si më poshtë vijon, në tabelën 1 të këtij vendimi, i anulohet financimi.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
4	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me ZRPP-në	Përditësimi dhe përmirësimi i të dhënave në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë	370,826,820	74,165,364	296,661,456

Shënim:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt bëhet me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6926/2 prot., datë 2.12.2015, dhe me kërkesë të sekretariatit teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 5280/2 prot., datë 5.1.2016. Financimi i këtij projekti do të kryhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2. Pika 5, në shënimet e tabelës 1 të këtij vendimi, shfuqizohet.

3. Totali i vlerës së projektit, si dhe vlera e financimit për vitet 2015 dhe 2016, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 40, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
	TOTALI		536,902,131	147,308,853	389,593,278

4. Numri rendor i totalit të projekteve, në tabelën 1 të këtij vendimi ndryshon: nga 5 projekte bëhet 4 projekte.